

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT
SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Raport sondazhi

Roli i Bashkisë Tiranë në zhvillimin e turizmit



Gusht 2025

Përmbajtja

Rreth sondazhit	3
Informacion i përgjithshëm	4
Përvoja me turizmin në Tiranë	5
Roli i Bashkisë Tiranë në turizëm	9
Informimi dhe aktivitetet	11

Rreth sondazhit

Në vitet e fundit, Bashkia e Tiranës ka ndërmarrë një sërë nismash konkrete që synojnë të forcojnë identitetin turistik të kryeqytetit dhe ta pozicionojnë atë si një destinacion tërheqës, jo vetëm për vizitorët vendas por edhe për ata ndërkombëtarë. Investimet në rikualifikimin urban, si shndërrimi i sheshit “Skënderbej” në një hapësirë publike moderne, rikonstruksioni i Kalasë së Tiranës dhe hapja e pazareve tradicionale, kanë krijuar një kombinim mes trashëgimisë historike dhe një jete urbane bashkëkohore.

Po ashtu, projekte si Parku i Liqenit të Madh Artificial, rikthimi i hapësirave të gjelbra dhe zhvillimi i infrastrukturës së biçikletave kanë kontribuar në promovimin e turizmit të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër, organizimi i eventeve ndërkombëtare kulturore dhe sportive, si Festivali i Filmit, Maratona e Tiranës apo Tirana Tirathlon, Tirana European Youth Capital 2022, Tirana kryeqyteti kulturës, e kanë rritur dukshmërinë e qytetit në hartën turistike evropiane. Këto nisma tregojnë qartë se Bashkia e Tiranës nuk e sheh turizmin thjesht si një aktivitet ekonomik, por edhe si një mjet për të nxitur zhvillimin urban, kulturor dhe social.

Ky sondazh synon të evidentojë perceptimin e turistëve dhe vizitorëve mbi rolin e Bashkisë së Tiranës në këto zhvillime, si dhe të masë ndikimin real që kanë pasur këto politika në krijimin e një identiteti turistik të qëndrueshëm dhe konkurrues.

Qëllimi i sondazhit është të evidentojë opinionet dhe vlerësimin e turistëve dhe vizitorëve për cilësinë dhe eksperiencat me turizmin në kryeqytet, si dhe për rolin e Bashkisë Tiranë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit në kryeqytet.

Objektivat e sondazhit:

- a) Opinionet e vizitorëve për atraksionet turistike;
- b) Vlerësimet për infrastrukturën turistike;
- c) Roli i Bashkisë në promovimin e turizmit nga këndvështrimi i vizitorëve;
- d) Fokusi që duhet të ketë Bashkia ndaj turizmit nga këndvështrimi i vizitorëve;
- e) Disponueshmëria e informacionit për atraksionet dhe aktivitetet;
- f) Sugjerime nga të anketuarit për zhvillimin e turizmit në Tiranë.


Sondazhi u zhvillua gjatë periudhës 30 korrik – 26 gusht 2025 dhe u anketuan turistë dhe vizitorë rastësorë në pikat më të frekuentuara në qytet¹. Anketimi u krye nëpërmjet intervistave ballë për ballë dhe u plotësuan 500 pyetësorë², si edhe online në faqen zyrtare të internetit <https://tirana.al/faqe/sondazhe>, duke e shpërndarë në rrjetet sociale instagram dhe facebook të Sektorit të Konsultimit Publik dhe Opinioneve Qytetare.

¹ Pikat ku është zhvilluar anketimi


² Pyetësori i sondazhit

Informacion i përgjithshëm


Nga totali i të anketuarve për këtë sondazh 53% janë femra dhe 47% meshkuj (*Grafiku Nr.1*).



Pjesëmarrja në sondazh sipas grup moshës: 36 – 50 vjeç (33%), 18 – 35 vjeç (27%), 51 – 65 vjeç (25%), nën 18 vjeç (8%) dhe mbi 65 vjeç (7%) (*Grafiku Nr.2*).




53% e të anketuarve janë turistë të huaj, 35% janë vizitorë nga qytete të tjera të vendit, ndërsa 11% janë banorë të Tiranës (*Grafiku Nr.3*).




Përvoja me turizmin në Tiranë


39% e të anketuarve janë shprehur se *kanë vizituar Tiranën gjatë vitit të fundit* për një periudhë dy ditore, 35% kanë qëndruar 3 – 4 ditë, 17% një javë, ndërsa 10% një ditë (*Grafiku Nr.4*).




70% e të anketuarve kanë vizituar Kalanë e Tiranës, 68% kanë vizituar Sheshin Skënderbej, 60% kanë vizituar Pazarin e Ri, 45% përkatësisht kanë vizituar Bunk'Art dhe Piramidën, 36% kanë vizituar Parkun e Madh të Liqenit, ndërsa 14% kanë vizituar edhe atraksione të tjera si Kalaja e Petrelës, Mali i Dajtit etj. (Grafiku Nr.5).



50% e të aketuarve e vlerësojnë mirë infrastrukturën turistike në kryeqytet, 32% mesatare, 14% shumë të mirë, ndërsa 4% të dobët (Grafiku Nr.6).




Mungesa e sinjalistikës për atraksionet dhe pastërtia e pamjaftueshme janë *vështirësitë më të hasura nga turistët dhe vizitorët* (36% përkatësisht), vështirësi në informacionin publik 33%, çmime të larta 31%, mungesë informacioni turistik 22%, vështirësi gjuhësore 14% dhe siguri e ulët vetëm 5% (Grafiku Nr.7).




Roli i Bashkisë Tiranë në turizëm


51% e të anketuarve janë shprehur se *roli i Bashkisë Tiranë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit* është i dukshëm, 36% e kanë vlerësuar si mesatar rolin e Bashkisë, 5% aspak të dukshëm, 4% shumë të dukshëm, ndërsa 3% pak të dukshëm (*Grafiku Nr.8*).



Në këndvështrimin e të anketuarve *Bashkia duhet të fokusohet më së shumti në përmirësimin e transportit urban dhe infrastrukturës përkatëse (65%), në krijimin e më shumë pikave të informacionit turistik (36%), në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve kulturore – artistike (32%), më shumë investime në digjitalizimin e informacionit turistik (30%), në promovimin e trashëgimisë historike dhe kulturore (29%) etj. (Grafiku Nr.9).*




55% e të anketuarve janë përgjigjur se janë mesatarisht të kënaqur me angazhimin e Bashkisë Tiranë në përmirësimin e shërbimeve turistike, 36% janë të kënaqur, 5% janë shumë të kënaqur, 3% pak të kënaqur, ndërsa 1% aspak të kënaqur (Grafiku Nr.10).




Informimi dhe aktivitetet


69% e turistëve/vizitorëve të anketuar janë përgjigjur se nuk kanë parë një pikë informacioni (info point) turistike në Tiranë, ndërsa 31% kanë pohuar se kanë parë një të tillë (Grafiku Nr.11).




- 31% e të anketuarve që janë përgjigjur se kanë parë një pikë (*info point*), janë shprehur rreth informacionit (*harta dhe udhëzimi që ju është dhënë*), nga të cilët:
 - 64% janë shprehur se informacioni ka qenë i qartë;
 - 31% janë shprehur se ka qenë shumë i qartë;
 - 4% disi i qartë;
 - 1% i paqartë (*Grafiku Nr.11/1*).



64% e të anketuarve janë përgjigjur se gjatë vizitës në Tiranë nuk kanë marrë pjesë në aktivitete kulturore (*festivale filmi, muze, ekspozita, koncerte etj.*), ndërsa 36% janë përgjigjur se kanë marrë pjesë (*Grafiku Nr.12*).



54% e të anketuarve janë shprehur se *informacionin për atraksionet turistike dhe aktivitetet* në Tiranë e marrin më së shumti nga rrjetet sociale (facebook, instagram etj.), 49% nga miq dhe të afërm, 24% nga info pointe, 24% nga broshura dhe guida, 21% nga mediat online dhe portale lajmesh, 20% nga faqja e internetit të Bashkisë Tiranë etj. (*Grafiku Nr.14*).



Sugjerime nga të anketuarit për të zhvilluar më tej turizmin në qytet

Rreth 10% e të anketuarve kanë dhënë edhe sugjerime se si mund të përmirësohet më tej turizmi në Tiranë:

- *Përmirësim të transportit publik;*
- *Me shumë info point-e;*
- *Më shumë zona të gjelbërta;*
- *Manaxhim më të mirë të mbetjeve;*
- *Më shumë guida turistike.*

Aneks I – **Pikat e anketimit**

Nr.	Pikat e përcaktuara për anketim	Nr. pyetësorë
1.	Sheshi Skënderbej (Blv Zogu I, Piazza, Rr.Durrësit, Pedonale, 9 kateshe)	50
2.	Kalaja e Tiranës	50
3.	Pazari i Ri	50
4.	Bunk ' Art 1/2	50
5.	Parku i madh i Liqenit	50
6.	Piramida e Tiranës	50
7.	Ish-Blloku	50
8.	Përreth Sheshit Italia (Arena, Rr.Gjon Pali II)	50
9.	Mozaiku i Tiranës	50
10.	Nëpër qytet	50

Aneks II – Pyetësi i sondazhit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MEDIAS DHE KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

DREJTORIA E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

SEKTORI I KONSULTIMIT PUBLIK DHE OPINIONEVE QYTETARE

Nr. i pyetësit _____

Tiranë, më ____/____/2025

Pyetësor – Roli i Bashkisë Tiranë në zhvillimin e turizmit

I - Informacion i përgjithshëm

<i>Nj.Administrative/Lagje</i>	<i>Gjinia</i>		<i>Mosha (vjeç)</i>				
	F	M	Nën 18	18 – 35	36 – 50	51 - 65	Mbi 65

Statusi: ☐ Banor i Tiranës ☐ Vizitor nga qytete të tjera të Shqipërisë ☐ Turist i huaj

II - Përvoja me turizmin në Tiranë

1. Sa herë keni vizituar Tiranën në 12 muajt e fundit?

- ☐ 1 herë
- ☐ 2-3 herë
- ☐ Më shumë se 3 herë
- ☐ Jetoj në Tiranë

2. Cilat janë atraksionet turistike që keni vizituar në Tiranë? (Mund të zgjidhni më shumë se një)

- ☐ Sheshi Skënderbej
- ☐ Kalaja e Tiranës
- ☐ Pazari i Ri
- ☐ Bunk'Art
- ☐ Parku i Madh i Liqenit
- ☐ Të tjera: _____

3. Si e vlerësoni infrastrukturën turistike në Tiranë? (rrugë, sinjalistike, transport publik, akomodim)

- ☐ Shumë e mirë
- ☐ E mirë
- ☐ Mesatare
- ☐ E dobët
- ☐ Shumë e dobët

4. A keni hasur ndonjëherë vështirësi gjatë vizitës në Tiranë (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- ☐ Mungesë informacioni turistik
- ☐ Vështirësi në informacionin publik
- ☐ Mungesë sinjalistike
- ☐ Pastërti e pamjaftueshme
- ☐ Siguri e ulët
- ☐ Cmime të larta
- ☐ Vështirësi gjuhësore

III - Roli i Bashkisë Tiranë në turizëm

5. Sa i dukshëm është roli i Bashkisë Tiranë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit?

- ☐ Shumë i dukshëm
- ☐ I dukshëm
- ☐ Mesatar
- ☐ Pak i dukshëm
- ☐ Aspak i dukshëm

6. Në cilat fusha mendoni se Bashkia duhet të fokusohet më shumë për të përmirësuar turizmin? (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- ☐ Krijimi i pikavetë informacionit turistik
- ☐ Zhvillimi dhe promovimi i aktiviteteve kulturore-artistike
- ☐ Përmirësimi i transportit urban dhe infrastrukturës rrugore
- ☐ Mbështetja e bizneseve locale (guida, artizanati, gastronomia)
- ☐ Promovimi i trashëgimisë historike dhe kulture
- ☐ Investime në digjitalizimin e informacionit turistik dhe hartave online
- ☐ Zhvillimi i turizmit të gjelbër dhe qëndrueshëm

7. Sa të kënaqur jeni me përpjekjet aktuale të Bashkisë për përmirësimin e shërbimeve turistike?

- ☐ Shumë i kënaqur
- ☐ I kënaqur
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Pak i kënaqur
- ☐ Aspak i kënaqur

IV – Informimi dhe aktivitetet

8. A keni parë ndonjë pikë informacioni (info point) turistike në Tiranë?

- ☐ Po ☐ Jo

- Nëse Po, si e vlerësoni organizimin dhe përmbajtjen?

- ☐ Shumë të mira
- ☐ Të mira
- ☐ Mesatare
- ☐ Të dobëta

9. Si e merrni zakonisht informacionin për atraksionet dhe aktivitetet në Tiranë? (Mund të zgjidhni më shumë se 1)

- ☐ Rrjete sociale (facebook, instagram)
- ☐ Faqa zyrtare e bashkisë
- ☐ Info point-e turistike
- ☐ Broshura/guidat turistike fizike
- ☐ Miq/të afërm
- ☐ Media online/portale lajmesh
- ☐ Të tjera: _____

9. Cilat janë sugjerimet tuaja për Bashkinë e Tiranës për të zhvilluar më tej turizmin në qytet?

Shënim: Ky pyetësor organizohet nga Bashkia e Tiranës dhe ka për qëllim të evidentojë opinionet dhe vlerësimin e vizitorëve për rolin e Bashkisë Tiranë në zhvillimin dhe promovimin e turizmit në kryeqytet. Ju sigurojmë që të dhënat tuaja janë për qëllim studimi dhe në përputhje me Ligjin nr 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjin nr. 120/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar”.

Ju falënderojmë për kohën që i kushtuat plotësimit të këtij pyetësori dhe për mendimet që ndatë me ne, me vlerë për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve të Tiranës.